

-
=



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 1259/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muharrem Shala kryesues, Xhevdet Abazi dhe Hasan Shala anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesat e Miranda Xhokli – Kandidate për Asamble Komunale (LDK) dega në Ferizaj paraqitur kundër Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ), për shkak të mungesës së votave, të zgjedhjeve lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2013, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohen si të pabazuara ankesat: Anr.1259, 1260, 1261, 1262, të datës 03.12.2013, të Miranda Xhokli – Kandidate për Asamble Komunale (LDK) dega në Ferizaj

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar ankesat: Anr.1259, 1260, 1261, 1262 të datës 03.12.2013, të Miranda Xhokli – Kandidate për Asamble Komunale (LDK) dega në Ferizaj, në të cilat ankesa pretendon se dyshon se ka pasur keqpërdorime, pa rregullsi gjatë procesit të numërimit të votave si dhe mungesë të votave.

- Në ankesën Anr.1259/13 të datës 03.12.2013, ka pretenduar se në në QV2516D/01R sipas komisionerëve i kamë 8 vota ndërsa sipas KQZ-së më figuronë 1 votë.
- Në ankesën Anr.1260/13 të datës 03.12.2013, pretendohet se në QV2509/01/02/03 janë 10 vota ndërsa sipas KQZ-së figurojnë 3 vota.
- Në ankesën Anr.1261/13 të datës 03.12.2013, pretendohet se në QV2526D/011/02/03D sipas informatave të KQZ-së më figuronë 1 votë.
- Në ankesën Anr.1262 të datës 03.12.2013 pretendohet se në QV2525D/02R sipas informatave i kamë të humbura 5 vota dhe nuk e kamë asnjë votë të fituar.

Bazuar në nenin 6.3 të “Rregullave dhe Procedurave” të PZAP-it, në të cilin parashihet se: “Me qëllim të lehtësimit të shqyrtimit të ankesave, Kryesuesi i Panelit mund të vendos ta bëjë bashkimin e ankesave që përmbajnë në vete çështje të ngjashme, paneli vendim-marrës i trajton ato ankesa sikurse të ishin një ankesë”. Në rastin konkret Kryesuesi i Panelit duke u bazuar në dispozitën ligjore të lartcekur ka vendosur ti bashkoi ankesat e sipërshënuara dhe ti trajtoi si një ankesë.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi ankesat gjeti se:

Ankesat janë të pa bazuara

Pretendimet ankimore nga ana e Miranda Xhokli – Kandidate për Asamble Komunale (LDK) dega në Ferizaj, paraqitur kundër Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ), ku dyshohet për pa rregullsi dhe keqpërdorime si dhe mungesës së konsiderueshme të votave nëpër QV, mirëpo nuk është ofruar asnjë provë relevante nga ana e palës ankuese, me të cilat do të mund të vërtetoheshin shkeljet e supozuara.

Prandaj për shkakun se nuk janë ofruar dëshmi bindëse për të vërtetuar se kanë ndodhur dhe janë evidentuar pa rregullsi dhe keqpërdorime gjatë procesit të votimit në QV, të lartcekura nga parashtruesi i ankesës, PZAP-i konstatoi se pretendimet ankimore janë të përgjithshme dhe të pa qarta për tu vërtetuar dhe ankesat e lartpërmendura u refuzuan si të pa bazuara, prandaj duke u bazuar në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesat e lartë përmendura u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 1259/2013 më datën 06.12.2013



Këshillë juridike: Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda 24 orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.